

LIGJI Nr. 05/L -095

PËR AKADEMINË E DREJTËSISË

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR AKADEMINË E DREJTËSISË

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

Me këtë ligj themelohet Akademia e Drejtësisë dhe rregullohet statusi, funksionet dhe organet e saj, mënyra dhe kushtet sipas të cilave kryhet trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të Republikës së Kosovës, trajnimi i personelit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe çështje të tjera në pajtim me ligjin.

Neni 2

Përkufizimet

1. Për qëllim të këtij ligji shprehjet e mëposhtme kanë këtë kuptim:

1.1. **Trajnuesit** – personat nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit dhe të profesioneve tjera relevante, të angazhuar për të mbajtur trajnime në Akademi.

1.2. **Mentorët** – gjyqtarët dhe prokurorët të angazhuar për të mentoruar pjesëmarrësit në trajnim.

Neni 3

Parimet e punës

Akademia e Drejtësisë (në tekstin e mëtejshëm: Akademia) e kryen funksionet e saj në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.

Neni 4

Logo dhe vula

Akademia ka logon dhe vulën e saj sipas formës dhe diametrit të përcaktuar me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi.

KAPITULLI II

STATUSI, FUNKSIONET DHE ORGANET E AKADEMISË

Neni 5

Statusi i Akademisë

1. Akademia është institucion publik i pavarur me cilësinë e personit juridik.
2. Akademia ka buxhetin e saj, i cili administrohet në mënyrë të pavarur në pajtim me ligjin.
3. Selia e Akademisë është në Prishtinë.

Neni 6

Funksionet e Akademisë

1. Akademia kryen funksionet e parapara si në vijim:
 - 1.1. harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 1.2. zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuar nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej: KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: KPK).
 - 1.3. organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 1.4. mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbartues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente;
 - 1.5. zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;
 - 1.6. mban të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 1.7. vendos dhe mban bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
 - 1.8. kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;
 - 1.9. kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;

1.10. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

Neni 7 **Organet e Akademisë**

1. Organet e Akademisë janë:

- 1.1. Këshilli Drejtues;
- 1.2. Këshilli Programor dhe
- 1.3. Drejtori Ekzekutiv.

Neni 8 **Këshilli Drejtues i Akademisë**

1. Këshilli Drejtues i Akademisë, (më tej: Këshilli Drejtues) udhëheq me Akademinë dhe përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy (2) janë anëtarë ex officio, ndërsa shtatë (7) anëtarë, nga institucionet e mëposhtme:

1.1. Anëtarët ex officio të Këshillit Drejtues janë:

1.1.1. Kryetari i Gjykatës Supreme dhe;

1.1.2. Kryeprokurori i shtetit;

1.2. tre (3) anëtarë të emëruar nga KGJK, dhe atë, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) gjyqtar nga Gjykata e Apelit dhe një (1) anëtar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës;

1.3. tre (3) anëtarë të emëruar nga KPK, dhe atë, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore, një (1) prokuror nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) anëtar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës;

1.4. një (1) anëtar i emëruar nga Ministri i Drejtësisë;

2. Anëtarët nga paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 deri 1.4 të këtij neni emërohen në kohëzgjatje prej katër (4) vite pa mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.

3. Institucionet që delegojnë më shumë se një anëtar duhet të marrin për bazë përfaqësimin gjinor dhe atë etnik.

4. Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit Programor.

5. Këshilli Drejtues, nga radhët e anëtarëve të tij zgjedh kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin me shumicë votash me mandat katër (4) vjeçar. Zgjedhja në këtë funksion nuk e zgjatë mandatin e anëtarit të Këshillit Drejtues.

6. Kryesuesi i Këshillit Drejtues përfaqëson Këshillin, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit dhe kryen përgjegjësi të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me Rregulloren e punës, të cilën e nxjerr Këshilli Drejtues.

Neni 9

Procedura e emërimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues

Inicimin e procedurës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues nga institucionet relevante e bën Këshilli Drejtues me kërkesë, jo më vonë se tre (3) muaj para skadimit të mandatit të anëtarëve aktual të Këshillit.

Neni 10

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues

1. Kompetencat e Këshillit Drejtues janë:

- 1.1. miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;
- 1.2. miratimi i projektbuxhetit të Akademisë;
- 1.3. miratimi i strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;
- 1.4. Miratimi i listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- 1.5. mbikëqyrja e punës së Akademisë;
- 1.6. përcaktimi i prioriteteve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- 1.7. zgjedhja dhe shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv;
- 1.8. emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Programor;
- 1.9. kryerja e punëve të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

2. Këshilli Drejtues sipas nevojës themelon komisione të veçanta që do ta ndihmonin në ushtrimin e kompetencave të parashtruara në paragrafin 1 të këtij neni. Këto komisione nuk kanë kompetenca vendimmarrëse.

3. Këshilli Drejtues i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës raport për punën e Akademisë së paku një herë në vit jo më vonë se data 31 mars.

Neni 11

Mënyra e punës dhe e vendimmarrjes e Këshillit Drejtues

1. Mbledhjet e Këshillit Drejtues i thërret dhe i kryeson Kryesuesi i Këshillit Drejtues.

2. Kryesuesi i Këshillit Drejtues mund të thërret mbledhjen e Këshillit Drejtues edhe me propozimin e së paku një të tretës (1/3) të anëtarëve të Këshillit Drejtues ose me propozimin e arsyetuar me shkrim të Drejtorit Ekzekutiv.
3. Njoftimet me shkrim për mbledhjet u dërgohen secilit anëtar të Këshillit, së paku pesë (5) ditë pune përpara dhe do të shoqërohen me agjendën e mbledhjes.
4. Këshilli Drejtues vendimet i nxjerr me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.
5. Këshilli Drejtues mban mbledhje të rregullta së paku katër (4) herë në vit, çdo tre (3) muaj nëse janë prezent më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Drejtues. Nëse në mbledhjen e thirrur sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, shumica e nevojshme sipas këtij paragrafi nuk është siguruar, Këshilli Drejtues mundet, në një mbledhje të radhës të thirrur së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë më vonë, të nxjerrë vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, por, vetëm nëse agjenda e takimit u është dërguar të gjithë anëtarëve të Këshillit.
6. Mënyra e punës dhe e vendimmarrjes në Këshillin Drejtues më për së afërmi rregullohet me Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues.

Neni 12

Pushimi i funksionit të anëtarit të Këshillit Drejtues

1. Funksioni i Anëtarit të Këshillit Drejtues pushon me:
 - 1.1. skadimin e mandatit;
 - 1.2. pushimin e statusit mbi të cilin bazohet emërimi;
 - 1.3. shkarkim;
 - 1.4. kërkesë të shkruar nga institucioni që e ka emëruar, duke njoftuar paraprakisht tridhjetë (30) ditë përpara Këshillin Drejtues;
 - 1.5 dorëheqje;
 - 1.6. vdekje.
2. Anëtari i Këshillit Drejtues mund të shkarkohet në pajtim me paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të këtij neni me vendimin e institucionit që e ka emëruar, mbi bazën e kërkesës së shumicës së anëtarëve të tjerë të Këshillit Drejtues, nëse anëtari, kryen ndonjërin nga veprimet e mëposhtme:
 - 2.1. funksionin e anëtarit të Këshillit Drejtues nuk e kryen në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;
 - 2.2. dështon të merr pjesë, pa arsye, në tri (3) mbledhjet e njëpasnjëshme të Këshillit Drejtues;
 - 2.3. ushtron funksionin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij; dhe
 - 2.4. është dënuar për vepër penale.

3. Në të gjitha rastet e parapara me paragrafin 1 të këtij neni, institucioni emërues duhet të njoftojë Këshillin Drejtues për ndërprerjen e funksionit të anëtarit mbrenda një afati të arsyeshem.

4. Nëse një vend lirohet në Këshillin Drejtues para skadimit të mandatit të një anëtari, pozita e lirë plotësohet në të njëjtën mënyrë si për anëtarin të cilit i ka skaduar mandati. Personi, i cili zgjedhet të plotësojë një vend të lirë në Këshillin Drejtues emërohet apo zgjedhet me një mandat të plotë katër (4) vjeçar.

5. Organi kompetent për emërim, obligohet që të marrë vendim lidhur me kërkesën e Këshillit Drejtues, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës dhe ta nojftojë Këshillin Drejtues në afat prej tetë (8) ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

6. Organi kompetent për emërim, emëron anëtarin e ri në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit për pushimin e funksionit të anëtarit të Këshillit Drejtues.

7. Përveç shkaqeve nga paragrafi 1 i këtij neni, kryesuesit të Këshillit Drejtues mund t'i pushoj funksioni i kryesuesit edhe me shkarkim në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues.

Neni 13

Kompenzimi i Anëtarëve të Këshillit Drejtues

1. Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë në kompensim për pjesëmarrje në mbledhje.

2. Anëtarët e Këshillit Drejtues marrin kompensim për çdo mbledhje të mbajtur mirëpo shuma e përgjithshme e kompensimit nuk mund të kalojë shumën prej dyqind (200) Euro për një (1) muaj, përjashtimisht kryesuesit të Këshillit Drejtues, i cili nuk mund të pranojë më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) Euro në muaj pavarësisht numrit të mbledhjeve të mbajtura brenda një (1) muaji.

Neni 14

Këshilli Programor

Këshilli Programor është organ profesional-i cili angazhohet për të siguruar cilësi për trajnimet e ofruara nga Akademia.

Neni 15

Përbërja e Këshillit Programor

1. Këshilli Programor përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë.

2. Drejtori i Akademisë është anëtarë ex officio.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor, me përjashtim të drejtorit ekzekutiv, është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Dispozitat për pushimin e funksionit të anëtarit të Këshillit Drejtues, të parapara me këtë ligj, përshtatshëmrisht vlejnjë edhe për pushimin e funksionit të anëtarit të Këshillit Programor.

4. Kryesuesi i Këshillit Programor është ex officio Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

5. Anëtarët e Këshillit Programor, me përjashtim të drejtorit ekzekutiv, kompensohen në lartësinë shtatëdhjetë (70%) të kompensimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues, në bazë të takimeve të mbajtura dhe pjesëmarrjes në takim.

Neni 16

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Programor

1. Këshilli Programor është organ profesional dhe ka këto kompetenca:

- 1.1. harton propozim programin e trajnimeve të Akademisë në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- 1.2. përcjell realizimin e programeve dhe suksesin e tyre;
- 1.3. jep orientime për avanciminin e metodave dhe teknikave trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;
- 1.4. jep mendim, për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
- 1.5. jep këshilla, propozimeve dhe sugjerimeve, organeve të Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
- 1.6. kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe akte nënligjore të Akademisë.

2. Për punën e tij Këshilli Programor i raporton Këshillit Drejtues.

Neni 17

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorit

1. Drejtori Ekzekutiv i Akademisë udhëheq Akademinë e Drejtësisë (me tej Drejtori) dhe ka këto kompetenca:

- 1.1. përfaqëson Akademinë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- 1.2. është përgjegjës për menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- 1.3. merr pjesë në punën e Këshillit Drejtues pa të drejtë vote dhe kryeson Këshillin Programor;
- 1.4. siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- 1.5. propozon projektbudgetin vjetor të Akademisë;
- 1.6. propozon programin e punës së Akademisë;
- 1.7. propozon Strategjinë, Planin e Punës dhe Programin e trajnimeve;

1.8. propozon listën e trajnerëve për miratim nga Këshilli Drejtues dhe nga lista cakton trajnuesit për zbatim të programit;

1.9. menaxhon me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;

1.10. propozon Projekt Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Akademisë, Projekt Rregulloren mbi përzgjedhjen e trajnuesve, Projekt Rregulloren e punës së Këshillit Drejtues, dhe Projekt Rregulloren e punës së Këshillit Programor dhe akte tjera nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;

1.11. përgatit raporte të rregullta vjetore dhe raporte të tjera sipas kërkesës së Këshillit Drejtues;

1.12. kryen edhe punë të tjera në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore të Akademisë.

2. Drejtori është zyrtar kryesor administrativ i Akademisë dhe është kompetent për rekrutimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e personelit të Akademisë në pajtim me dispozitat për shërbimin civil.

3. Drejtori ka statusin e Udhëheqësit të Lartë Drejtues siç është përcaktuar në Ligjislacionin për Shërbimin Civil dhe për punën e tij është përgjegjës ndaj Këshillit Drejtues.

Neni 18

Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit

1. Për t'u emëruar Drejtor, kandidati duhet t'i plotësoj kushtet si në vijim:

1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

1.2. të ketë diplomë universitare në fushën e drejtësisë, të vlefshme në Republikën e Kosovës;

1.3. të ketë të dhënë provimin e jurisprudencës;

1.4. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;

1.5. të ketë punuar si gjyqtarë, apo prokurorë për së paku pesë (5) vite, apo të ketë tetë (8) vite përvojë pune, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë menaxheriale;

1.6. të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për veprë penale.

2. Kandidatët të cilët kanë ardhur nga pozita e gjyqtarit apo prokurorit, pas përfundimit të mandatit si drejtor i Akademisë, mund të kthehen për të ushtruar funksionin të cilin e kanë ushtruar para emërimit në këtë pozitë.

3. Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv bëhet përshtatshëmrisht me dispozitat për emërimin në pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Procedura e përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv bëhet nga Këshilli Drejtues mbi bazën e

konkursit publik.

5. Këshilli Drejtues themelon Komisionin Përzgjedhës në përbërje prej pesë (5) anëtarëve prej të cilëve: dy (2) nga radha e Këshillit Drejtues, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore dhe një (1) përfaqësues i shoqërisë civile.

6. Këshilli Drejtues me shumicën e votave vendos për emërimin e Drejtorit Ekzekutiv.

7. Procedura e përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv përcaktohet në detaje me akt nënligjor të miratuar nga Këshilli Drejtues, duke reflektuar parimet e shërbimit civil.

KAPITULLI III AKTIVITETET TRAJNUESE

Neni 19

Trajnimi fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit

1. Akademia organizon trajnim fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar.

2. Trajnimi fillestar do të zgjas dymbëdhjetë (12) muaj dhe përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike. Trajnimi teorik realizohet me mbështetjen e trajnuesve, ndërsa trajnimi praktik me mbështetjen e mentorit.

3. Akademia gjatë trajnimit mban të dhëna dhe nxjerrë rezultatet e pjesëmarrësve në trajnimin fillestar, në bazë të të cilave do të vendoset për përfundimin në mënyrë adekuate të trajnimit fillestar nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar.

4. Pas përfundimit të trajnimit fillestar, gjyqtarët dhe prokurorët do t'i nënshtrohen vlerësimit në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi, dhe në bazë të rezultateve të treguara gjatë trajnimit fillestar në Akademi.

5. Me kërkesë të specifikuar të KGJK-së dhe KPK-së, Akademia do të organizoj trajnime shtesë për gjyqtarët dhe prokurorët me performancë jo të kënaqshme.

6. mënyra e zbatimit të trajnimit përcaktohet me rregullore nga Këshilli Drejtues.

Neni 20

Trajnimi i vazhdueshëm për gjyqtarë, prokurorë të shtetit dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

1. Me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm dhe avancimit të shkathtësive dhe ekspertizës së duhur profesionale dhe interdisiplinare, gjyqtarët, prokurorët dhe stafi administrativ marrin pjesë në trajnimet e vazhdueshme.

2. Trajnimi i vazhdueshëm është vullnetar. Përrjashtimisht kësaj, me kërkesë të KGJK-së, KPK-së, kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve të prokurorive, disa trajnime mund të jenë të detyrueshme për gjyqtarët, prokurorët apo stafin administrativ, varësisht nga performanca e tyre në punë.

3. Akademia publikon në ueb-faqe programin vjetor të trajnimit për vitin e ardhshëm më së voni deri me datë 1 dhjetor të vitit aktual, nëse për realizimin e programit të planifikuar është siguruar buxheti i mjaftueshëm. Këshilli Programor vazhdimisht e rifieskon programin trajnues, ashtu siç e konsideron të nevojshëm duke marr parasysh kërkesat e institucioneve përkatëse.
4. Pjesëmarrja në trajnime duhet t'iu ofrohet të gjithë përfituesve pa pagesë. Shpenzimet e ushqimit ofrohen nga buxheti i Akademisë, ndërsa ato të udhëtimit mbulojnë nga buxheti i KGJK-së, përkatësisht KPK-së.
5. Pjesëmarrja në trajnime bëhet në mënyrë të koordinuar në mes Akademisë, KGJK-së, KPK-së, kryetarëve të gjykatave, kryeprokurorëve të prokurorive dhe përfaqësuesve të profesioneve të lira.
6. Pjesëmarrësve në trajnime të vazhdueshme pas përfundimit të trajnimit, u lëshohet certifikatë.

Neni 21

Trajnimet për avancim

1. Akademia organizon trajnime për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që janë avancuar në detyrë, qoftë në departamente brenda të njëjtit nivel apo edhe në nivele më të larta.
2. Gjyqtarët dhe prokurorët e avancuar duhet të marrin pjesë në këto trajnime.

Neni 22

Trajnimi për avokat shtetëror, avokatë dhe profesionet e tjera të lira

1. Sipas kërkesave të institucioneve kompetente dhe varësisht nga mundësitë, Akademia mund të organizoj trajnime, duke përfshi por, pa u kufizuar për:

- 1.1. avokatë shtetëror;
- 1.2. avokatë;
- 1.3. noterë;
- 1.4. përmbarues privat;
- 1.5. ndërmjetësues;
- 1.6. administratorë falimentues.

2. Për trajnimet e ofruara për kategoritë e përcaktuara nga nënparagrafi 1.2 deri 1.6 të këtij neni, institucionet përkatëse ose profesionale obligohen t'i mbulojnë shpenzimet e trajnimit, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe kushtet e tregut, sipas tarifave të përcaktuara me rregulloren e miratuar nga Këshilli Drejtues.

3. Kërkesat për trajnime nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të dërgohen në Akademi, jo më larg se data 1 nëntor, për programin trajnues në vitin vijues. Në raste të veçanta kërkesat për trajnime mund të pranohen edhe pas kësaj date, nëse Akademia ka mundësi t'i realizojë ato.

4. Pjesëmarrësve në trajnime nga paragrafi 1 i këtij neni, pas përfundimit të trajnimit të vazhdueshëm, u lëshohet vërtetim.

KAPITULLI IV TË PUNËSUARIT NË AKADEMI

Neni 23

Të punësuarit në Akademi

1. Numri i nëpunësve në Akademi përcaktohet me aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Akademisë.

2. Dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil, zbatohen edhe për nëpunësit civil në Akademi, nëse me këtë ligj nese nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 24

Trajnuesit dhe mentorët

1. Trajnuesit në Akademi janë gjyqtarë, prokurorë, profesorë universitarë dhe profesionistë të tjerë. Trajnuesit janë të përkohshëm ose të përhershëm.

2. Mënyra e përzgjedhjes së trajnuesve të përhershëm nga radhët e gjyqtarëve dhe të prokurorëve përcaktohet me rregullore të brendshme të KPK-së dhe KGJK-së, të cilët i propozohen për miratim Këshillit Drejtues të Akademisë, për periudhën një (1) vjeçare, me mundësi të vazhdimit më së shumti edhe dy herë.”

3. Trajnuesit e përhershëm të cilët nuk janë gjyqtarë dhe prokuror të shtetit themelojnë marrëdhënie pune në Akademi sipas rregullave të shërbimit civil.

4. Trajnuesit e përkohshëm angazhohen sipas nevojës për zbatimin e programit të trajnimeve.

5. Të drejtat dhe detyrat e trajnuesve dhe të mentorëve të përkohshëm rregullohen me kontratë në mes të tyre dhe Akademisë.

6. Trajnuesit dhe mentorët e Akademisë janë të detyruar të marrin pjesë në programet për trajnim të trajnuesve të Akademisë.

7. Mënyra e përzgjedhjes së trajnuesve dhe mentorëve, përjashtimisht trajnuesit nga paragrafi 2 i këtij neni, përcaktohen me rregullore të miratuar nga Këshilli Drejtues bazuar në një proces transparent dhe konkurrues.

Neni 25

Kompensimi i trajnuesëve dhe mentorëve

1. Trajnuesit e përhershëm kanë të drejtë në pagë në pajtim me Ligjin, i cili rregullon pagën e shërbyesve civilë, ndërsa trajnuesit e përhershëm nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit kanë të drejtë në pagën e njëjtë të cilën do të kishin për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, respektivisht të funksionit të prokurorit të shtetit, e cila paguhet nga buxheti i KGJK-së,

respektivisht KPK-së.

2. Trajnuesit e përkohshëm kanë të drejtë në kompensim për punën lidhur me zbatimin e përkohshëm të trajnimit në pajtim me vendimin e Këshillit Drejtues.

3. Mentorët propozohen nga KGJK-ja përkatësisht KPK-ja dhe miratohen nga Këshilli Drejtues. Mentorët kanë të drejtë në kompensim, të përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

KAPITULLI V FINANCIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 26 Financimi i Akademisë

1. Akademia financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

2. Të hyrat e realizuara nga Akademia derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

3. Gjatë procesit të rregullt buxhetor të përcaktuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të merren në konsideratë projeksionet për të hyrat e pritura nga paragrafi 2 i këtij neni.

4. Aktiviteti vjetor i Akademisë duhet të jetë në harmoi me ndarjet vjetore buxhetore të këtij institucioni.

Neni 27 Mbiqëqyrja financiare

Akademia menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e saj dhe i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në përputhje me ligjin në fuqi.

Neni 28 Donacionet

Akademia mund të pranoj donacione shtesë nga donatorë vendor dhe ndërkombëtar.

KAPITULLI VI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 29 Dispozitat Kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, të punësuarit në Institutin Gjyqësor të Kosovës vazhdojnë të punojnë në Akademi, në pajtim me dispozitat e këtij Ligji.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji Akademia është trashëgues juridik i Institutit Gjyqësor të Kosovës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, anëtarët e Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, Drejtori ekzekutiv dhe anëtarët e Këshillit Programor, do të vazhdojnë t'i kryejnë kompetencat dhe përgjegjësitë deri në emërimin e Anëtarëve të rinjë të Këshillit Drejtues, Drejtorit ekzekutiv dhe të anëtarëve të Këshillit Programor, përkatësisht deri në përfundimin e mandatit.
4. Kandidatët të cilët janë duke ndjekur trajnim në Institutin Gjyqësor të Kosovës do të vazhdojnë trajnimin në Akademi edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në përfundimin e plotë të programit trajnues dhe statusi i tyre do të jetë i njëjtë me atë të kandidatëve që do të fillojnë trajnimet në Akademi.
5. Brenda gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të nxirren aktet nënligjore të parapara me këtë ligj.
6. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas këtij ligji, zbatohen aktet nënligjore të cilat janë në fuqi.
7. Termi Institutit Gjyqësor i Kosovës i përmendur në çdo ligj apo akt nënligjor në fuqi zëvendësohet me termin Akademia e Drejtësisë.

Neni 30 Shfuqizimi

Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.02/L-25 për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Viti III/ nr. 23/ 1 Prill 2008.

Neni 31 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L-095
19 janar 2017**

Shpallur me dekretin Nr. DL-008-2017, datë 03.02.2017 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.